



REPUBLICA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**PROGRAMET E KURRIKULËS PËR SHKOLLËN E MESME TË GJUHËVE
TË HUAJA (GJIMNAZ GJUHËSOR)**

FUSHA: GJUHË E HUAJ

LËNDA: GJUHË FRËNGE

KODI: 3.2.12.Zgj(av)

PROGRAMI I LËNDËS
GJUHË FRËNGE
PËR KLASËN E 12-TË

Koordinatorë: Erifili Hashorva

Redaktore letrare: Vjola Grillo

Përgjegjëse sektori: Marita Hamza

TIRANË, NËNTOR 2010

Në kushtet e integritit të Shqipërisë me vendet e Bashkimit Europian, mësimi i gjuhës së huaj në shkollën e mesme të gjuhëve të huaja, si përbërës i kurrikulës së re bërthamë, zë një vend me rëndësi në formimin qytetar të brezit të ri, për krijimin e një mjedisi shumëgjuhësor, shumëkulturor, duke synuar integrimin gjithnjë e më të shpejtë të nxënës/it,-es në mjedisin e përbashkët europian.

Formimi gjuhësor, përvetësimi i gjuhëve të huaja në shkollat e mesme të gjuhëve të huaja ndikon jo vetën në formimin shkencor të nxënësve, por mbi të gjitha, në formimin e individualitetit të nxënës/it,-es, si dhe në ndërtimin e qëndrimeve dhe të sjelljeve etike, që i shërbejnë komunitetit dhe krijojnë një qytetar të ri të Europës, të gatshëm për t'u integruar dhe për të kontribuar në përparimin e shoqërisë.

Programi i gjuhës frënge të avancuar ndërtohet mbi interesat intelektuale dhe karakteristikat e grupmoshës, duke kontribuar në zhvillimin e pavarur, intelektual dhe social-kulturor të nxënës/it,-es.

Programi i klasës së 12-të i gjuhës frënge të avancuar, i mbështetur në arritjet e përfuara nga nxënësit si dhe në interesat personale të tij, parashikon përvetësimin e njohurive gjuhësore e social - kulturore, duke siguruar, përveç mësimi të gjuhës, edhe përfitim të qëndrimeve dhe të sjelljeve të caktuara që inkurajojnë zhvillimin e individualitetit të nxënës/it,-es, respektimin e shumëllojshmërisë kulturore, të interesave dhe prirjeve individuale të nxënës/it,-es, duke lehtësuar komunikimin dhe shkëmbimet gjuhësore në të ardhmen. Programi i referohet nivelit të arritur deri në klasën e dymbëdhjetë, njohurive të përfuara nga mësimdhënia/mësimnxënia në bazë të programit formues të kurrikulës bazë, si dhe asaj të avancuar.

Programi i kurrikulës me zgjedhje të detyruar bazohet në kurrikulën kombëtare, si dhe në përkrahjet e Kuadrit të Përbashkët Europian të Referencave për Gjuhët. Ky program synon zhvillimin e aftësive të të vepruarit në mënyrë individuale dhe kolektive, duke nxitur veprimin e lirë dhe komunikimin në grup, avancimin dhe thellimin e mëtejshëm në njohuritë e gjuhës së huaj, duke motivuar arritjen e objektivave dhe të standardeve të të nxënës sipas kërkesave dhe standardeve të përcaktuara nga MASH-i dhe Kuadri i Përbashkët Europian i Referencave për Gjuhët.

Kurrikula me zgjedhje (e avancuar) synon perfeksionimin e njohurive në mësimin e gjuhës nëpërmjet integritit të aftësive bazë (të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit, të shkruarit dhe të folurit bashkëveprues), për të arritur rezultate pozitive në testet e vlerësimit të gjuhës së huaj në Maturën Shtetërore, bazuar në kërkesat dhe standardet europiane të vlerësimit DELF B2+.

Bazuar në arritjet e programit pararendës, si dhe në synimin e kurrikulës, ai mëton përdorimin e regjistrave të ndryshëm në përdorimin e gjuhës së folur dhe asaj të shkruar, si dhe thellimin e njohurive formuese civilizuese europiane.

Temat e trajtuara në klasën e 12-të u referohen kërkesave të kurrikulës kombëtare, si dhe Kuadrit të Përbashkët Europian të Referencave për Gjuhët, në përshtatje me interesat social-kulturore të vetë nxënësve, si dhe me synimet e programit të avancuar për nxënësit e klasës 12-të të shkollës së gjuhëve të huaja.

Nxënës/i,-ja, si përdorues i pavarur i gjuhës frënge në kuadrin e kërkesave dhe standardeve të Kuadrit Europian të Referencave, si dhe të portofolit europian të gjuhëve, përdor në mënyrë mjaft të saktë një repertor strukturash ("skemash") në situata të paparashikueshme, në përputhje me temat dhe strukturat që thellohen, duke zhvilluar dhe duke justifikuar idetë e shprehura me ide dytësore të argumentuara, me fakte dhe eksperiencat e reja.

1. SYNIMI I LËNDËS

Synimi i gjuhës së huaj në këtë fazë të formimit është të aplikojë, të perfeksionojë aftësitë e fituara në nivelet e mëparshme, në mënyrë që nxënës/i,-ja të arrijë të konsolidojë nivelin **B2+**, duke u aftësuar gjithnjë e më shumë si një përdorues i pavarur i gjuhës. Në këtë nivel, synohet që nxënës/i,-ja të bëhet sa më i/e pavarur, duke pasqyruar efektshmëri dhe një shkallë të lartë të argumentimit. Në këtë nivel, synohet që nxënës/i,-ja, si përdorues i pavarur i gjuhës frënge:

- Të përpunojë informacionin mbi situata të paparashikuara të jetës së përditshme, si dhe të situatave të tjera të veçanta, qartë dhe me efektshmëri, duke vendosur lidhjet e tij me situatën dhe me bashkëfolësin;
- të sintetizojë mendimet, idetë e paraqitura në veprimtari individuale, dhe të punës në grup për arritjen e objektivave të të nxënës;
- të perfeksionojë aftësinë komunikuese dhe përdorimin e njohurive gjuhësore në situata të veçanta të jetës së përditshme;
- të forcojë efektshmërinë e ndërveprimit në kontekstin mësimor, si dhe t'i përgjigjet këtij ndërveprimi, duke u thelluar në përdorimin e të katër aftësive gjuhësore.

2. OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM

Programi i gjuhës frënge për klasën e 12-të ka si objektiv të përgjithshëm të pasqyrojë dhe të ndërthurë njohuritë e gjuhës frënge me njohuritë e lëndëve të tjera. Gjatë procesit të të nxënës të gjuhës së huaj, objektivat e përgjithshëm të programit synojnë që nxënës/i,-ja:

- Të perfeksionojë aftësitë leksiko-gramatikore dhe kulturore, për të ndërtuar një personalitet gjithnjë e në rritje, në përgjigje të kërkesave të shtruar nga Kuadri i Përbashkët Europian i Referencave për Gjuhët, si dhe nga dokumentet bazë nënshkruar nga MASH-i.
- Të realizojë një ndërveprim, shkëmbim komunikativ në situata bashkëvepruese efektive.
- Të mbajë qëndrim ndaj materialeve burimore në shërbim të të mësuarit duke argumentuar, sintetizuar, krahasuar problematikat që trajtohen; si dhe duke mbajtur qëndrim ndaj tyre.
- Të perfeksionojë të katër aftësitë e të nxënës të gjuhës së huaj, duke thelluar njohuritë e përfutuara në fushat e tjera të të nxënës.
- Të ndërthurë aftësitë personale, njohuritë në kulturën e përgjithshme me ato specifike në gjuhën frënge për të thelluar më tej shkallën e dijeve.
- Të nxitet që, krahas njohjes së kulturës së huaj, të forcojë dhe të ruajë vlerat kulturore kombëtare.
- Të thellohet në aftësinë për të vënë në dukje, për të krahasuar dhe për të bërë dallime ndërmjet kulturave të ndryshme, për t'iu përshtatur sa më mirë komunikimit ndërkulturor evropian.
- Të zhvillojë më tej aftësinë e të menduarit në mënyrë krijuese dhe kritike, duke konsoliduar shprehitë dhe proceset e të menduarit kritik dhe krijues në interpretimin e njohurive në gjuhën frënge.

3. OBJEKTIVA SIPAS STANDARDEVE

a) Objektiva sipas standardit në komunikim

Përshkrimi: Objektivat e standardeve në këtë fushë i japin më shumë rëndësi formimit dhe ndërveprimit gjuhësor për të ngritur në një nivel më të lartë cilësor komunikimin në gjuhën frënge. Nxënës/i,-ja tashmë argumenton pikëpamjet e tij/saj. Kjo i jep nxënës/it,-es elementet bazë të komunikimit, qofshin ato leksiko-gramatikore, që lidhen me regjistrin e gjuhës, fushën e përdorimit, apo elemente etiko-emocionale, që lidhen me gjestet, traditën, pasthirmat - elemente të rëndësishme në sigurimin e funksioneve ndërvepruese të komunikimit. Në këtë nivel, nxënës/i,-ja, si përdorues i pavarur, shprehet thjesht, qartë, jep dhe kërkon sqarime.

Standardi	Objektiva
Komunikimi	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të bëjë parashikime e hipoteza rreth një situatë problemore, duke argumentuar idetë e tij/saj; • të interpretojë një informacion të dhënë nga fusha të ndryshme të interesit, duke sintetizuar konkluzionet respektive; • të organizojë thelbin dhe detajet e një bisede; • të modifikojë formulimin e tij/saj me qëllim eliminimin e perifrazimeve; • të justifikojë idetë e tij/saj duke i mbështetur në argumente dhe fakte të dhëna nga dokumentet burimore apo jeta e përditshme; • të krahasojë zgjidhjet e ndryshme duke argumentuar, justifikuar zgjedhjen e tij/saj; • të nxjerrë në dukje faktet dhe interpretimet e tyre; • të klasifikojë pikat e rëndësishme apo më pak të rëndësishme të një diskutimi, duke argumentuar pikat pro dhe kundër; • të sintetizojë argumentet dhe qëndrimin e tij/saj ndaj një teze apo ideje të caktuar; • të hartojë një tekst argumentues, duke respektuar qëllimin si dhe rregullat strukturore dhe ato etike në përshtatje me qëllimin e këtij argumentimi.
Veprimtaritë e komunikimit	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të mirëpresë idetë dhe përvojat e të tjerëve;

	<ul style="list-style-type: none"> • të kundërshtojë në debat, me argumente të bazuara, një ide apo një opinion duke mbrojtur pikëpamjen e tij/saj rreth temës së debatuar; • të formulojë një ankesë për të negociuar zgjidhjen e saj; • të propozojë zgjidhje për situata të caktuara; • të mbështesë me mjete social-gjuhësore ndjenjat dhe qëndrimet e tij/saj, si: keqardhjen, çudinë, dëshirën, urimin etj; • të nxisë marrjen pjesë në shtrimin e një diskutimi, duke krijuar mundësi të njëjta për të gjithë; • të verifikojë detajet mbështetëse të një argumenti për përvoja të ndryshme, në situata të jetës së përditshme, si: festa, takime, ditëlindje, treg, vende të panjohura, shkollë, mbrëmje, ekskursione.
--	--

b) Objektiva sipas standardit në kulturë

Përshkrimi: Objektivat e standardeve në këtë fushë parashikojnë një shkallë të ndërgjegjësimit kulturor, si dhe thellim në etikën e komunikimit, duke siguruar jo vetëm njohuri të reja, por dhe ndërgjegjësime mbi vlerat kombëtare dhe ato europiane.

Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja, përdorues i pavarur i gjuhës frënge, aftësohet të njohë fusha të caktuara të kulturës frënge dhe asaj frankofone, si: historia, kinemaja, kënga franceze, artet pamore etj., duke përgjithësuar karakteristika të veçanta. Njëkohësisht, mund të bëjë komente mbi to duke shfaqur admirimin, pëlqimin, mospëlqimin dhe shije të tjera.

Standardi	Objektiva
Kultura	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përdorë gjuhën frënge në situata të ndryshme gjuhësore dhe kulturore, duke ua përshtatur regjistrin e komunikimit gjuhësor audiencës dhe qëllimit të komunikimit (normal, informal, miqësor, konfidencial, zyrtar etj.); • të përdorë strategjitë e duhura të të nxënës, me qëllim zgjerimin e mëtejshëm të kompetencave social-gjuhësore dhe social-kulturore; • të thellojë njohuritë e tij/saj mbi kulturën frënge, si dhe për personalitete të ndryshme të saj, mbi ngjarje dhe personalitete përfaqësues të ngjarjeve të ndryshme me karakter formues në botën frankofone; • të përdorë saktë shenjat social-gjuhësore, si p.sh.,

	<p>gjestet, intonacionin në ligjërim etj., që përcaktojnë qëndrimin ndaj bashkëfolësve në bashkëbisedim;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të motivojë shijet dhe zgjedhjet personale dhe të grupit që përfaqëson mbi artin e kulturën, shkollën dhe jetën e përditshme, duke motivuar zgjedhjet e tij/saj (grupit që përfaqëson); • të komentojë vlerat e një emisioni televiziv, radiofonik, një filmi, një drame, një koncerti apo një veprë letrare, duke i analizuar dhe duke i krahasuar elementet e veçanta në sjelljen e personazheve dhe duke argumentuar edhe mendimin e tij/saj.
--	--

c) Objektivat sipas standardit në formimin gjuhësor

Përshkrimi: Objektivat e standardit në këtë fushë e aftësojnë nxënës/in,-en të prodhojë elemente gjuhësore që i përkasin nivelit B2+. Nëpërmjet situatave të ndryshme ligjërimore, nxënës/i,-ja nxitet të praktikojë struktura gramatikore të gjuhës frënge, si dhe të kuptojë lidhjen dhe përdorimin e saktë të tyre. Këtu vihet theksi në përpunimin e njohurive gramatikore të përfutuara në nivelet e mëparshme gjuhësore, në dhënien e strukturave të reja gjuhësore, si dhe në përdorimin e tyre në situata më të ndërlikuara, duke nxjerrë në pah raportet e ndryshme morfo-sintaksore në shprehjen e idesë.

Standardi	Objektiva
Elemente gramatikore	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të zotërojë një kontroll shumë të mirë gramatikor, duke evituar çdo lloj gabimi që të çon në keqkuptime; • të kombinojë shumë mirë format morfo-sintaksore, duke aplikuar saktë strukturat gjuhësore me gabime të vogla të rastësishme, të cilat nuk cenojnë në asnjë rast kuptimin; • të zotërojë në situata të ndryshme, para një audience, një shqiptim dhe një intonacion të lirshëm dhe natyral; • të përdorë drejtshkrimin dhe shenjat e pikësimit në mënyrë të saktë sipas rregullave të drejtshkrimit të gjuhës frënge; • të bëjë një përshkrim ose një tregim të lirë në zhvillim, duke argumentuar pikat e rëndësishme, me ndihmën e detajeve dhe të shembujve domethënës; • të përdorë me efikasitet një larmi të madhe fjalësh lidhëse, për të shënuar e theksuar marrëdhëniet mes ideve; • të përdorë saktë në mënyrë krijuese foljen si kategori duke ua përshtatur drejt vlerat modale dhe kohore situatave të ligjërimin me shkrim dhe me gojë; • të përdorë saktë në kontekstin e duhur ligjëratën e

	<p>drejtë dhe atë të zhdrejtë, duke realizuar përshtatjet e duhura morfo-sintaksore;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përdorë saktë të gjitha elementet morfo-sintaksore të shprehura me përemra dhe mbiemra në varësi të qëllimit, kontekstit të ligjërimit; • të ndërtojë drejt fjalinë e përbërë, duke përdorur drejt artikulorët dhe duke respektuar elementet e koherencës dhe të kohezionit.
--	---

4. OBJEKTIVAT SIPAS AFTËSIVE GJUHËSORE

Aftësia	Objektiva
Të dëgjuarit	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të ndjekë lehtësisht një bisedë të gjallë midis folësish vendës, duke identifikuar me saktësi argumentet që mbështesin dhe kundërshtojnë pikëpamjet; • të ndjekë, me pak sforcim, pjesën më të madhe të një bisede autentike bërë në praninë e tij; • të kuptojë në detaje një ligjërimit në gjuhë standarde, edhe pse të zhvilluar në një ambient të zhurmshëm; • të kuptojë idetë kryesore të një ligjërimit të ndërlikuar në brendi dhe në formë, mbi një temë konkrete ose abstrakte; • të përthithë përmbajtjen informative të një materiali të regjistruar; • të kuptojë pikëpamjen dhe qëndrimin e folësve, nëpërmjet elementeve të intonacionit që përdoren; • të ndjekë një argumentim apo debat kompleks, mbi një temë të njohur dhe të strukturuar qartë; • të ndjekë një leksion, një bisedë të drejtpërdrejtë apo një regjistrim radio-televiziv, mbi tema të njohura dhe të panjohura, që lidhen me veprimtarinë personale, shoqërore apo akademike; • të kuptojë emisione televizive, intervista, drama filma dhe gjini të tjera të spektaklit të shprehura në gjuhë standarde.
Të lexuarit	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të zotërojë një fjalor leximi të gjerë dhe aktiv që e ndihmon në kuptimin dhe interpretimin e dokumentit burimor; • të lexojë në mënyrë të pavarur, duke ua përshtatur mënyrën dhe shpejtësinë e leximit teksteve të ndryshme dhe objektive, duke përdorur referenca të përshtatshme në mënyrë përzgjedhëse;

	<ul style="list-style-type: none"> • të lexojë një korrespondencë të përditshme dhe ta interpretojë atë; • të kuptojë përshkrimin e ngjarjeve, të ndjenjave dhe të dëshirave në mënyrë të mjaftueshme për të mbajtur një korrespondencë të rregullt me një mik korrespondent; • të përshkojë shpejt një tekst të gjatë dhe kompleks, duke klasifikuar detajet respektive; • të përthithë me shpejtësi përmbajtjen dhe domethënien e dokumenteve burimore informative mbi tema që lidhen me interesat e tij/saj; • të identifikojë shpejt përmbajtjen, duke përzgjedhur informacionin e përshtatshëm nga artikuj dhe reportazhe e duke vendosur nëse i duhet një studim më i thellë; • të kuptojë artikuj të specializuar jashtë fushës së tij/saj, edhe me ndihmën herë pas here të fjalorit, për të verifikuar kuptimin.
<p style="text-align: center;">Të folurit</p>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të komunikojë i sigurt mbi tema të njohura, të zakonshme ose të ndryshme nga interesat e tij/saj; • të verifikojë/konfirmojë informacione; • të realizojë një ndërveprim, një komunikim me folës vendës (francezë), duke sjellë një informacion konkret duke përballuar jo vetëm situata të zakonshme, por edhe të paparashikuara; • të përballojë një debat; • t'u japë vlerë argumenteve në mbështetje apo kundër pikëpamjes së tij/saj; • të shtrojë qartë një çështje, problem duke arsyetuar rreth shkakut dhe pasojës, si dhe duke vlerësuar avantazhet dhe disavantazhet e qasjeve të ndryshme; • të raportojë informacione dhe argumente nga një numër burimesh, si dhe të arrijë në përfundimet e duhura; • të hartojë përshkrime dhe prezantime të qarta dhe të detajuara, duke parashtruar ide të rëndësishme dhe duke i mbështetur me shembujt e duhur; • të negociojë për zgjidhjen e një problemi që ka ngjallur debat; • të japë qartë e rrjedhshëm njoftime për çështje të përgjithshme, pa shkaktuar keqkuptime dhe vështirësi të dëgjuesi.
<p style="text-align: center;">Të shkruarit</p>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shkruajë tekste të qarta dhe të hollësishme mbi një gamë të gjerë temash brenda dhe jashtë fushës së tij/saj të interesit;

	<ul style="list-style-type: none"> • të bëjë sintezën dhe vlerësimin e informacioneve dhe të argumenteve të marra nga burime të ndryshme; • të realizojë lidhjet midis ideve në një tekst të shkruar me rrjedhë logjike, duke respektuar rregullat e gjinisë në fjalë; • të sintetizojë kritikën e një filmi, të një libri apo të një pjese teatrale; • të vlerësojë idetë e ndryshme ose zgjidhjet e një problemi; • të shkruajë një esë ose një raport që zhvillon një argumentim, duke justifikuar pro ose kundër një pikëpamje të veçantë dhe duke shpjeguar përparësitë ose problemet e opsioneve të ndryshme.
--	--

5. KËRKESA TË GJUHËS FRËNGE NDAJ LËNDËVE TË TJERA

Programi i gjuhës frënge për klasën 12-të të shkollës së mesme të gjuhëve të huaja mbështetet në integrimin ndërlëndor, duke e shfrytëzuar atë për aftësimin në rritje të nxënësve në përdorimin e njohurive gjuhësore, në përgjithësi, dhe të katër aftësive (të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit), në veçanti.

Konceptet dhe njohuritë gjuhësore trajtohen e mësohen më mirë në kontekste të caktuara kuptimore, që lidhen ngushtë me fusha tematike të parashtruara në programin e gjuhës frënge dhe të trajtuara në lëndët e tjera. Ky ndërveprim reciprok vërehet në veprimtari të ndryshme të ndërsjella, si:

- Ndërthurja mes gjuhës së huaj dhe matematikës shprehet në diskutimin e shifrave, të numrave të shprehur në komunikimin dhe në studimin e elementeve të veçanta në gjuhën e huaj.
- Lidhja e gjuhës së huaj me shkencat natyrore, p.sh., me biologjinë, reflektohet në trajtimin e temave në lidhje me mjedisin, ushqyerjen, shëndetin etj.
- Mësimi i gjuhës frënge ndihmon nxënës/in,-en të thellohet në studimin e praktikave dhe të programeve informatike prodhuar në gjuhën frënge, programe që zhvillojnë shprehitë në proceset informatike, si dhe thellojnë njohuritë e nxënësve në gjuhën frënge.
- Temat për sportin, muzikën, modën dhe pikturën, krahas njohurive kulturore për këto fusha, thellojnë aftësitë njohëse në gjuhë të huaj, rrisin dëshirën për ndërveprim kulturor dhe për komunikim me anë të gjuhës së huaj.
- Shkencat sociale janë të pranishme në trajtimin e temave, si: miqësia, marrëdhëniet familjare, problemet dhe aktualitetet social-politike të trajtuara në tekst, si dhe kontribuojnë drejtpërdrejt në përpilimin dhe në hartimin e projekteve kurrikularë në gjuhë të huaj.

Trajtimi ndërlëndor u shërben synimeve të përgjithshme të programit, si dhe realizimit të objektivave të tij, kryesisht për:

- Edukimin intelektual: Përmes ndërthurjes së njohurive të ndryshme, nxënës/it,-et arrijnë të zbulojnë, të analizojnë, të sintetizojnë dhe të vlerësojnë, duke rritur cilësinë e nxënies.
- Atdhedashurinë: Duke njohur kulturat e popujve të vendeve frëngjishtfolëse, nxënës/it,-et bëjnë krahasime me kulturën amtare dhe ndërgegjësohen për identitetin e tyre kombëtar.
- Edukimin mjedisor: Ndotja dhe mbrojtja e mjedisit janë tema që shoqërohen me fjalor e struktura gjuhësore, të cilat trajtohen jo si një qëllim më vete, por në një kontekst kuptimplotë dhe edukativ.
- Edukimin kulturor dhe etik: Përmes lëndëve historike dhe gjeografi, nxënës/it,-et fitojnë njohuri për vendet frëngjishtfolëse.
- Edukimin për të drejtat e njeriut: Realizohet e lidhur ngushtë me temat e barazisë sociale, të diskriminimit social, të respektit reciprok etj.

6. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Ky program është dokument zyrtar i detyrueshëm për t'u zbatuar nga përdoruesit e tij (mësues etj.).

Përdoruesve të këtij programi u lind nevoja të njohin standardet e të gjitha fushave të tjera të të nxënësve dhe të gjitha programet lëndore të së njëjtës klasë, për të siguruar një ndërveprim ndërlëndor.

A. Objektivat

Objektivat e parashtruar në programin e gjuhës frënge për klasën e 12-të të shkollës së mesme të gjuhëve të huaja janë të detyrueshme për t'u realizuar nga mësuesi dhe duhen përvetësuar nga nxënës/i,-ja që do të thotë se të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia të përvetësojnë objektivat e programit. Objektivat janë të detyrueshme për t'u zbatuar sipas shkallës së vështirësisë. Realizimi i objektivave në tema dhe unitete mësimore, si dhe renditja e tyre në funksion të realizimit të objektivit brenda unitetit është zgjedhje e lirë e mësues/it,-es. Puna e diferencuar me nxënësit kushtëzohet nga fakti që brenda klasës kemi nxënës me nivele të ndryshme përparimi.

B. Orët mësimore

Shpërndarja e orëve mësimore: 34 javë x 2 orë = 68 orë vjetore

Gjuha frënge për klasën e 12-të për nivelin e avancuar zhvillohet me 2 orë mësimore në javë. Gjatë shtjellimit linear të lëndës në tekst (në kapituj e njësi mësimore) aftësitë gjuhësore dhe kulturore ndërthuren me njëra-tjetrën. Mësues/i,-ja është i/e lirë të bëjë kombinimin e tyre brenda një kapitulli ose një njësie mësimore, pavarësisht renditjes në tabelën e shpërndarjes së orëve.

Shpërndarja e orëve të planifikuara është si vijon:

Komunikimi dhe formimi kulturor zë 48 orë, të cilat ndahen, sipas objektivave që u përgjigjen, në 34 orë mësimore për kulturën dhe komunikimin (70% e tyre, që përbëjnë 24 orë, do të jenë për trajtimin e lëndës së re, kurse 30% e tyre, që përbëjnë 10 orë, do të shërbejnë për përpunimin e njohurive. Me përpunim do të kuptojmë, p.sh., përforsimin e informacionit të marrë në temat përkatëse ose ushtrime për mendimin kritik rreth këtij informacioni). Aktet dhe funksionet e komunikimit do të

zënë 14 orë për (70% e tyre, që përbëjnë 10 orë mësimore, do të shërbejnë për njohuritë e reja, kurse 30% e tyre, d.m.th. 4 orë mësimore, do të përdoren për përpunimin e njohurive. Këtu mësuesi bën përpunim njohurish për integrimin tërësor të lëndës. Aii jep detyra komplekse, ku pasqyrohen njohuritë e përfuara sipas aftësive dhe objektivave në një kapitull).

Formimi gjuhësor zë 20 orë. Janë kryesisht orë në të cilat mësuesi shtjellon, në bashkëveprim me nxënësit, njohuri gramatikore dhe ushtrime gjuhësore gramatikore e leksikore (70% e tyre, që përbëjnë 14 orë mësimore, do të shërbejnë për trajtimin e strukturave të reja, kurse 30% e tyre, që përbëjnë 6 orë, do të shërbejnë për rimarrjen, përpunimin dhe përforcimin).

Nga orët e përpunimit dhe të përforcimit të njohurive, mësuesi, në përputhje me planin vjetor, planifikon orët e përsëritjes dhe të kontrollit me shkrim dhe me gojë.

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përfshin:

- Thellim në njohuritë bazë;
- integrimin e njohurive të reja bazuar në dokumente burimore brenda dhe jashtë tekstit.

Gjatë përpunimit të njohurive, duhet t'i kushtohet kohë e posaçme:

- Kultivimit të aftësive të përgjithshme, si: të komunikimit, të menaxhimit të informacionit, të zgjidhjeve problemore dhe të të menduarit kritik e krijues;
- kultivimit të aftësive gjuhësore: të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit;
- formimit të qëndrimeve, si qëndrimin etik-social dhe atij gjatë punës në grupe të vogla nxënësish.

Mësuesi zhvillon edhe tema me nismën e tij ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund të kenë pikënisjen nga ngjarje aktuale ose thjesht nga kureshtja e nxënësve.

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive, nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të punojnë detyra tematike e projekte kurrikulare, të zgjidhin situata problemore nga jeta etj.

Pjesë e përpunimit të njohurive është edhe përsëritja, e cila ka për qëllim të nxjerrë në pah dhe të përforcojë konceptet kryesore.

Metoda dhe strategji të mësimdhënies/nxënies

Mësimdhënia ka në qendër të saj metodën komunikative, metoda me bazë detyrën, metodën funksionale dhe atë të situatave sa më afër jetës reale etj.

Në këtë nivel, mësuesi do të vazhdojë të përshtatë një metodologji që e konsideron gjuhën si sistem dhe, për rrjedhojë, do të koordinojë veprimtari që synojnë të katër aftësitë, d.m.th. të punojë me kompetenca të integruara.

Mësuesi mund të ndryshojë funksionin e caktuar të teksteve dhe të dokumenteve.

Për një tekst të dhënë, veprimtaritë e propozuara do të ndryshojnë sipas qëllimit. Nëse lexojmë për të kuptuar përmbajtjen për një sensibilizim lidhur me atë çfarë paraqitet në dokumentin burimor, ose për përdorimin e mënyrave të sistemit

foljor, mësuesi duhet të parashikojë veprimtari që mbështesin objektivin e orës mësimore të caktuar. Mësuesi duhet të mbajë vazhdimisht parasysh rritjen e shkallës së vështirësisë ose dozimin e njohurive në formulimin e kërkesave të detyrave dhe të ushtrimeve që do të propozojë. Metodologjia e ndjekur nga mësuesi synon kalimin nga më e njohura në thellim dhe përvetësim të njohurive të reja.

Për një mësimdhënie të gjuhës për qëllime komunikimi, është e domosdoshme të krijosh një motivim për një të folur që të jetë sa më i justifikuar: simulim nevojash (vënie në skenë në klasë, simulime të përgjithshme, situata komunikimi të qarta, shfrytëzim i mjedisit, shkëmbimeve midis shkollave, letërkëmbimeve telematike, me internet, ose me kaseta audio dhe video), por edhe kënaqësia për të luajtur, për të komunikuar, për t'u shprehur dhe për të dëgjuar tjetrin.

Njëkohësisht, mësues/i,-ja duhet të punojë që nga ana e nxënës/it,-es të përdoren në shërbim të arritjes së objektivave të gjitha strategjitë e nevojshme për formimin e aftësive gjuhësore repsektivisht:

Të dëgjuarit

Për të zhvilluar aftësinë e të dëgjuarit, nxënës/i,-ja ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- Të përqendrohet gjatë dëgjimit;
- të mbajë shënime gjatë dëgjimit;
- të klasifikojë çështjet që dëgjon;
- të bëjë lidhje mes asaj që dëgjon dhe materialit pamor;
- të përqendrohet te kërkesa e dëgjimit;
- të vërë qëllime dhe objektiva për zhvillimin e aftësisë së dëgjimit;
- të kuptojë gjatë dëgjimit referencat kulturore, duke i krahasuar ato me respektivet në kulturën kombëtare.

Të folurit

Për të zhvilluar aftësinë e të folurit, mësuesi/i,-ja ushtron nxënës/in,-en të ndjekë këto strategji:

- T'i kërkojë bashkëbiseduesit përsëritje, në rast moskuptimi;
- të mos ndalojë plotësisht ligjërimin, kur nuk di një fjalë ose shprehje, por të përdorë shprehje e fjalë të njohura që shpjegojnë situatën;
- të përdorë shprehje dhe gjeste tipike të gjuhës frënge, me qëllim që të fitojë kohë për të shprehur idenë e dëshiruar;
- të përsërisë një pjesë të asaj që thotë bashkëbiseduesi, për të miratuar se biseda ndërmjet tyre po përcillet në mënyrë të drejtë kuptimore;
- të pyesë bashkëbiseduesin për të bërë të qartë atë që është thënë.

Të lexuarit

Për të zhvilluar aftësinë e të lexuarit, mësuesi/i,-ja ushtron nxënës/in,-en të ndjekë këto strategji:

- Të kërkojë të dhëna që e ndihmojnë për të parashikuar përmbajtjen e tekstit, si: figura, titulli i mësimit, dy rreshtat e parë të mësimit;
- të lexojë tekstin dhe të nxjerrë kuptimin e ideve në kontekst;
- të lexojë pyetjet rreth tekstit dhe të hamendësojë përgjigjet e mundshme;

- të gjejë referenca të ideve të shprehura në tekst, në materiale të tjera burimore, qofshin ato të karakterit kombëtar apo të tjera që kanë lidhje me problematikën e shprehur në dokumentin burimor bazë.

Të shkruarit

Për të zhvilluar aftësinë e të shkruarit, mësuesi/i,-ja ushtron nxënës/in,-en të ndjekë këto strategji:

- Të plotësojë paragrafët bosh në tekstin e dhënë me informacion mbështetës, si: shembuj, sqarime etj.;
- të kontrollojë lidhjen logjike të paragrafëve, duke përdorur lidhëzat dhe modalitetet e duhura;
- të redaktojë shkrimin, të mbajë shënime për atë çfarë i kërkohet në detyrën e caktuar; ose të këmbejë punën e tij/saj me atë të shokut/shoqes.

C. Parime për zbatimin e programit

Zbatimi i programit mbështetet në parimet e mëposhtme:

Vendosja e nxënës/it,-es në qendër të vëmendjes

Programi i gjuhës frënge të avancuar rrit njohuritë gjuhësore të nxënës/it,-es përmes temave që u përshtaten programit dhe interesave të nxënës/it,-es, duke i dhënë mundësi të jetë në qendër të procesit mësimor. Strategjitë e parashikuara nxisin ndërveprimin gjuhësor dhe komunikativ, duke e përfshirë nxënës/in,-en në organizimin e veprimtarive dhe në përdorimin e teknikave që i përshtaten individualitetit të tij/saj, duke i forcuar besimin në komunikimin ndëraktiv në gjuhën frënge.

Krijimi i mjedisit të të nxënës

Zgjedhja e nivelit të avancuar siguron krijimin i një atmosfere gjuhësore motivuese dhe konkurruese, si dhe një mjedis miqësor, emocional, duke synuar demokratizimin e mësimin dhe të marrëdhënieve në shkollë. Krijimi i mjedisit të përshtatshëm të të nxënës, ndihmuar nga mjetet e teknologjisë në funksion të të mësuarit, lehtëson përdorimin e formave të bashkëpunimit në klasë dhe thëllon njohuritë në gjuhën frënge, si dhe ato shkencore të fushave të tjera të të nxënës.

Organizimi i klasës

Mësues/i,-ja dhe nxënësit bashkëpunojnë për organizimin e mësimdhënies/mësimnxënies. Për ta lehtësuar mësimdhënien/mësimnxënien, mësuesi/ja gjen mënyra frytdhënëse për të organizuar veprimtaritë komunikuese, siguron dhe sugjeron materiale burimore për nxënësit etj. Mësues/i,-ja i qartëson nxënësit dhe merr mirëkuptimin e tyre për atë çfarë ndodh në klasë. Kjo nënkupton sqarimin e rregullave të radhës së punës dhe të përgjegjësisë të nxënësve në procesin e kryerjes së veprimtarive.

Mësues/i,-ja sugjeron dhe siguron përdorimin e mjeteve audiovizuale, elektronike dhe ndihmon nxënës/in,-en në përdorimin e formave të ndryshme të teknologjisë informative brenda dhe jashtë klase. Përdorimi i *site*-ve të internetit duhet të jetë i kontrolluar, në mënyrë që burimet të jenë origjinale dhe me baza shkencore. Kështu mësuesi dhe nxënësit duhet të sugjerojnë *site* të ndryshme dhe mundësi të tjera për thellimin e njohurive, të cilat do të ndihmojnë në përvetësimin e gjuhës së huaj.

Të mësuarit bashkëveprues

Mësues/i,-ja krijon kushtet për realizimin e mësimit në mënyrë bashkëkohore, të të mësuarit bashkëveprues, realizuar në grupe apo çifte, duke siguruar ndërveprimin gjuhësor dhe bashkëpunimin mes nxënësve gjatë organizimit të veprimtarive në klasë. Ai/ajo përdor forma të larmishme që i përshtaten nivelit dhe veçorive individuale të nxënësve. Ato variojnë nga ndërveprimi në çift apo në grup. Këto forma i bëjnë nxënësit më bashkëveprues, më të pavarur në shprehjen e mendimit të tyre dhe në respektimin e ideve të të tjerëve.

Përdorimi i gjuhës në klasë

Në nivelin gjuhësor B2+, nxënësi është më i formuar nga ana gjuhësore e kulturore dhe është i gatshëm të përdorë gjuhën frënge në situata komunikimi për veprimtari që lidhen me veprimtarinë dhe interesat e tij.

Përdorimi i gramatikës në kontekste të reja të panjohura

Në kuadër të respektimit të Kuadrit të Përbashkët European të Referencave për Gjuhët, gramatika thellohet në bashkëveprim në një kontekst të caktuar, referuar kërkesave të nivelit B2+. Njohuritë gjuhësore janë në shërbim të funksionit komunikativ të gjuhës, cilësia e të cilit varet nga saktësia gramatikore dhe nga rrjedhshmëria gjuhësore

Korrigjimi i gabimeve

Programi i gjuhës frënge për klasën e 12-të, në nivelin e avancuar synon aftësimin e nxënësve në korrigjimin e gabimeve. Mësuesi duhet të synojë organizimin e një ore mësimi ku të mbizotërojë respekti për fjalën dhe punën e tjetrit dhe çdo diskutim t'u shërbejë objektivave të përcaktuar nga dokumentacioni bazë miratuar nga MASH-i dhe Kuadri i Përbashkët European i Referencave për Gjuhët.

Puna e diferencuar me nxënësit

Në kushtet e mësimit të gjuhës së huaj në shkollën kombëtare të profilit gjuhësor, mësuesit i duhet të konceptojë në punën e tij edhe një dimension të punës së diferencuar, me grupe dhe me nxënës të veçantë, në vartësi me interesat e prirjet e tyre individuale dhe krahinore, duke respektuar nxënësi/n,-en dhe personalitetin e tij/saj.

Për të siguruar ndërveprimin në mësimin e avancuar të gjuhës së huaj, është e rëndësishme të përcaktohet nga mësues/i,-ja dhe nxënësit puna kërkimore që synon një thellim të punës në mënyrë individuale dhe në grupe. Në këtë veprimtari, mësuesi duhet të konceptojë detyra dhe projekte të larmishme që tërheqin vëmendjen e interesat e grupeve dhe të nxënësve të veçantë. Mësuesi mund të krijojë grupe të përziera, në varësi të objektivave që synon, si dhe në bazë të interesave të nxënësve, për të mos i vënë në vështirësi, por për t'i inkurajuar në zgjidhjen e detyrave.

Këtij objektivi i shërben, gjithashtu, edhe organizimi i veprimtarive kulturore me bazë gjuhën e huaj, si: recitime, vënie në skenë të pjesëve të ndryshme në gjuhë të huaj,

ekspozita etj. Duke konsideruar formimin shumëgjuhësh në edukimin e nxënësve në shkollën e mesme të gjuhëve të huaja si pjesë përbërëse e edukimit në këtë shkollë, mësuesi nxit studimin, krahasimin mes strukturave gjuhësore të veçanta. Nxënësit mund të sjellin një kontribut të konsiderueshëm nëpërmjet transferimit të njohurive të tyre nga gjuha dhe kultura amtare në gjuhën dhe kulturën e huaj dhe anasjelltas.

7. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësit në këtë nivel mbështetet tërësisht në objektivat, në programin lëndor të gjuhës frënge të avancuar.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etiko-sociale, në përgjithësi, dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët.

Duke vlerësuar kurrikulën në kornizën e Kuadrit të Përbashkët European të Referencave për Gjuhët, theksojmë që kriteret dhe mënyrat e vlerësimit në këtë nivel duhen përshtatur me kërkesat e nivelit B2+ të vlerësimit të arritjeve. Është detyrë e çdo mësuesi që, krahas formulimit të objektivave të qartë në përputhje me kurrikulën dhe me Kuadrin e Përbashkët European të Referencave për Gjuhët, të bëjë edhe vlerësimin hap pas hapi të çdo kompetence të nxënësit.

Për mësuesin e gjuhës së huaj, të vlerësosh nxënësin do të thotë të vlerësosh kompetencat e tij në komunikimin me shkrim e me gojë.

Etapa të vlerësimit

Vlerësimi kalon përmes disa etapave, të cilat përfshijnë kontrollin, matjen dhe vlerësimin.

Kontrolli lidhet me rrugën e përfundimit të informacionit mbi atë që ka arritur dhe atë që nuk ka arritur nxënësi gjatë thellimit në mësimin e gjuhës së huaj. Kontrolli realizohet në forma të ndryshme dhe në çdo moment të të mësuarit.

Matja shpreh rezultatin e kontrollit krahasuar me kushte, me kritere, standarde të caktuara paraprakisht dhe paraqitet në pikë, përqindje etj. Duhet thënë se jo çdo kontroll përfundon me matje.

Vlerësimi lidhet me vendosjen e vlerës me anë të notës, shprehjes me fjalë (*mirë, shumë mirë* etj.) në përputhje me gjykimin sasior e cilësor që rezulton nga kryerja e matjes.

Çdo veprimtari e akt komunikimi duhet të vlerësohet në kuadrin e arritjeve të të nxënësit, në mënyrë që hap pas hapi të realizohen objektivat e përgjithshëm dhe ata specifikë për mësimin e gjuhës së huaj në përputhje me kornizën kurrikulare dhe Kuadrin e Përbashkët European të Referencave për Gjuhët.

Vetëvlerësimi

Vetëvlerësimi është një tjetër element i rëndësishëm i vlerësimit në mësimin e gjuhës frënge, ku secili nxënës/-e jep gjykimin për zotësinë e vet. Vetëvlerësimi është një element plotësues i domosdoshëm i vlerësimit të njohurive nga mësues/i,-ja, nga prindërit dhe nga institucionet arsimore. Vetëvlerësimi ka efekt kur:

- U referohet normave dhe kapacitetit që Kuadri i Përbashkët European të Referencave për Gjuhët parashtron për grupmoshën dhe nivelin e tyre;
- lidhet me një përvojë të veçantë gjuhësore e ndërkulturore.

Vetëvlerësimi i të nxënit bëhet i matshëm nëpërmjet përcaktimit të synimeve të qarta në program. Si mjet në vlerësim dhe vetëvlerësim shërben Portofoli European i Gjuhëve (PEGj), që me anë të tri pjesëve të tij: Pasaportës Gjuhësore, Bibliografisë Gjuhësore dhe Dosjes, nxisin nxënësin të mendojë mbi nivelin e tij gjuhësor, duke vetëvlerësuar njohuritë e marra, dhe dokumentimin e arritjeve të tij gjuhësore që mund të jenë provime me shkrim, detyra tematike, certifikata, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare.

Portofoli European i Gjuhëve është dokumenti në të cilin çdo nxënës që mëson ose ka mësuar një gjuhë që mësohet në shkollë ose jashtë saj, mund të shënojë njohuritë e tij gjuhësore dhe përvojat kulturore. PEGj-i e nxit nxënësin të mësojë më shumë gjuhë, edhe në nivele modeste, dhe të vazhdojë t'i mësojë gjuhët përgjatë gjithë jetës. PEGJ-i e nxit nxënësin të përmirësojë mësimin dhe aftësinë e vlerësimit të aftësive të tij në fushën e gjuhëve. PEGj-i kontribuon në mirëkuptimin reciprok në Europë nëpërmjet njohjes së drejtpërdrejtë të kulturave të tjera dhe ndihmës së kapaciteteve të komunikimit në shumë gjuhë.

- Nxënësit, gjithashtu, vlerësojnë punën e njëri-tjetrit në grupe, duke marrë role të ndryshme, madje dhe pa nevojën e ndihmës së mësuesit.
- Nxënës/i,-ja mban shënim arritjet e tij/saj, duke përdorur edhe gjuhën amtare.
- Mësues/i,-ja bisedon me nxënës/in,-en individualisht dhe tregon arritjet e tij/saj.

Interesi më i madh i vetëvlerësimit qëndron në faktin se ai është faktor motivimi dhe ndërgjegjësimi. Ai i ndihmon nxënësit të njohin pikat e tyre të forta dhe të dobëta dhe kështu, të organizojnë më mirë të nxënësit e tyre. Nga vetëvlerësimi përfiton si nxënës/i,-ja, ashtu edhe mësues/i,-ja.